

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama: Korrupsioni po goditet, jo po rritet! S'do të pranojmë linçimin publik pa gjyq
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/rama-korrupsioni-po-goditet-jo-po-rritet-sdo-te-pranojme-linc-i1185947
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:52:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4b043df23a3a101023e560ebdf7135cfa39cacf7489816c3237654473ce0072f
TEKSTI	b050ab34e406c0929eb68a5d128124a8363ead4e7ba80c8aff25ce455ccc206e
PAMJA	6a648323e960222940d3f9c280608abd7b94a1b1226c88a827808d5b3a5c313e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ed139f44cba08f11319990b492d72d621749b34388f6b0e51a41329368696782
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ed139f44cba08f11319990b492d72d621749b34388f6b0e51a41329368696782>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rama: Korrupsioni po goditet, jo po rritet! S'do të pranojmë linçimin publik pa gjyq



Nga A2 CNN

27 Shtator 2026, 14:47 | Politikë



Kryeministri Edi Rama deklaroi se arrestimi i ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, nuk provon se qeveria është e mbërthyer nga korrupsioni, por se drejtësia po vepron dhe po mbështetet nga shumica qeverisëse pavarësisht kostove politike.

"Nuk kam asnjë gjë tjetër për të shtuar por tani kam ende për të thënë për kuptimin politik të këtij zhvillimi pasi edhe këtë herë u ngrit në kupë të qiellit një aktakuzë kundër qeverisë dhe meje personalisht, me refrenin e shfrenuar; na mbyti korrupsioni. Pavarësisht bindjeve dhe kahjes së votës, fakti që drejtësia prek edhe njerëz me funksione të larta, anëtarë të qeverisë e bashkëpunëtorë nuk provon se na mbyti korrupsioni apo se po shtohet. Përkundrazi. Faktet se në episodet e këtij kapitulli të ri për Shqipërinë nuk provon asesi që shumica qeverisëse është e korruptuar. Ky fakt, këto episode, kjo drejtësi e re ku kurrë më parë nuk ka pasur një lloj drejtësi të pavarur, ku s'ka pasur kurrë një udhëheqje politike e interesuar për ti dhënë pavarësi apo forcë politike për ta mbështetur atë duke marrë përsipër kostot, provojnë të kundërtën e avazit që na mbyti korrupsioni. Korrupsioni po goditet nuk po rritet. Shumica e qeverisëse është e palëkundur në luftën kundër korrupsionit mbi të gjitha brenda radhëve të saj. Jemi të angazhuar deri në fund, qoftë për reforma qoftë për përballimin e kostove politike që sjell angazhimi kundër korrupsioni i organeve të drejtësisë" tha Rama.

Kryeministri tha se qeveria mbetet e angazhuar në luftën kundër korrupsionit, ndërsa ngriti shqetësimin për rrjedhjen e sekretit hetimor në media, duke e cilësuar atë si një formë linçimi publik të personave nën hetim para se të zhvillohet gjyqi.

"Askush nuk mund të pretendojë që sekretin hetimor ta ruajnë mediat. Problemi nuk nis te zëdhënësit informalë të oborrit të drejtësisë nëpër ekrane. Ata përdoren nga prokurorët dhe gjykatësit për t'i shpallur njerëzit fajtorë pa nisur gjyqi, njësoj si në një diktaturë, ku pasi mbarojnë punë mjetet e propagandës, gjyqi mbetet formalitet. Ky problem, që nis te paligjshmëria e ligjëruar brenda oborrit të drejtësisë, ku sekretit hetimor shpërdorohet për të linçuar, nuk mund të anashkalohet."

Kryeministri sqaroi gjithashtu se Vlora Hyseni u emërua në krye të SHISH pas punës si këshilltare e tij dhe mbi bazën e referencave pozitive nga shërbime partnere, duke theksuar se çështja e saj tashmë i përket drejtësisë.

"Orvatjet për ta shpjeguar emërimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH-it me lloj-lloj fantazish konspirative s'kanë lidhje me të vërtetën. E vërteta është e thjeshtë. Ka nisur të punojë pranë meje në rolin e këshilltares. Pas një periudhe jo të shkurtër në atë rol, si edhe bazuar në referenca të shkëlqyera të marra nga shërbime partnere, ajo është emëruar drejtuese e SHISH-it. As nuk vihet sot në diskutim se ish-drejtuesja e SHISH-it ka hapur një llogari të vështirë me drejtësinë, veçse ka hyrë në një borxh të madh moral në këtë vend. Por, po ashtu, as nuk diskutohet që ky vend nuk bëhet kurrsesi më i drejtë kur njerëzit e sotëm nën hetim nga prokuroria linçohen në tezgat mediatike, as kjo shoqëri nuk bëhet kurrsesi më e mirë kur i fryn zjarrit të atyre turrave", tha Rama.

TE FUNDIT

Dorëhiqet Vuçiç: Nder i madh të isha president, do t'i kujtoni këto vite...!

Poezia e Dhimitër Pojanakut, një mbrëmje mes vargut, muzikës dhe emocioneve

Plazh në vjeshtë, në Durrës vijojnë prenotimet nga pushues vendas e të huaj

9 të arrestuar në Zubin Potok, dyshohen për krime lufte në rastin e "grupit të intelektualëve"

MË TË VIZITUARAT

Britania e Madhe në alarm, eksplozivë në bazën e përdorur nga SHBA, disa të a...

Alarm për eksplozivë pranë bazës RAF Fairford në Mbretërinë e Bashkuar, evaku...

Të kërkuar në Itali dhe Kosovë, arrestohen në Rinas dy persona

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“SHISH u bë target kombëtar e ndërkombëtar thashethemesh”, Rama: Në Këshillin e Sigurisë të reflektojmë përgjegjësitë



Arrestimi i Vlora Hysenit, Rama mesazh shqiptarëve nga Rinas: Masë ekstreme



Rama mbërrin në Rinas, pritet mesazhi për shqiptarët. Gazetarët janë lënë jashtë



“Abuzim që të lë pa mend!” Braçe denoncon abuzimet me çmimet e produkteve ushqimore dhe kursin e euros





Rama mesazh shqiptarëve nga Rinas pas kthimit nga SHBA. Nesër mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare



“Kjo tragjedi e prek nga afër Shqipërinë”, MEPJ reagon për shpërthimin me 6 viktima në Athinë

Latest Videos






Të presim drejtësinë! Politikani i AAK: Kjo nuk është përplasje Prishtinë-Tiranë, por..!



"S' duhet të ketë asnjë panik. Nuk kthehet prapë '97, mos kini frikë..!" Ndaj Hysenit..!



"Çfarë është gjetur në SMS? Nuk ka asnjë informacion sekret! Max 4-5 vite burg dhe..!" Rexhaj



"Kurti e hoqi Vlorën se nuk e kapte dot. Ajo me lidhje me SHBA, Kurti pa asnjë marrëdhënie me ta..!"

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Ballkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulo

Imagjinatë

Dëshmi

Facebook

Twitter

Instagram

YouTube

A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësonar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.